KRYETARIT

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo

UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

1

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**
**СКУПШТИНА КОСОВА**
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

# T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 20 NËNTOR 2003

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 20.11.2003. GODINE

NËNTOR - NOVEMBAR
2003

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo

UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

# KUVENDI I KOSOVËS
# СКУПШТИНА КОСОВА
# ASSEMBLY OF KOSOVO

## RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Sportin (2003/27),
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kadastër (2003/30),
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transportin rrugor (2003/32),
5. Përgjigjet e ministrave në pyetjet e deputetëve.
6. **Propozimi i rendit të ditës për Seancën plenare më 4 dhjetor 2003:**

   6.1 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet dhe pajisjet medicinale (2003/17),
   6.2 Shqyrtimi i Projek Buxhetit për vitin 2004.

## ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице,
2. Друго разматрање Нацрта закона о спорту (2003/27),
3. Друго разматрање Нацрта закона о катастру (2003/30),
4. Прво разматрање Нацрта закона о путном транспорту (2003/32),
5. Одговори Министра на посланичка питања.
6. **Предлог дневног реда за пленарну седницу 4 децембра 2003:**

   6.1 Друго разматрање Нацрта закона о медицинским продуктима и опреми (2003/17),
   6.2 Разматрање Предлог Буђета за 2004 годину.

UNITED NATIONS
United Nations Interim Administration Mission in Kosovo

UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration Intérimaire des Nations Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

# KUVENDI I KOSOVËS
# СКУПШТИНА КОСОВА
# ASSEMBLY OF KOSOVO

## AGENDA

1. Approval of the minutes from the previous meeting,
2. Second reading of the Draft Law on Sport (2003/27),
3. Second reading of the Draft Law on Cadastre (2003/30),
4. First reading of the Draft Law on Road Transport (2003/32),
5. Answer of Ministers to the deputies questions.
6. **Proposal for the Agenda of the Plenary Session on 4 December 2003:**

   6.1 Second reading of the Draft Law on medicinal products and equipments (2003/17),
   6.2 Review of the Draft Budget for 2004 year.

Sekretariati i Shërbimeve të Kuvendit - Ndërtesa e Kuvendit / Ndërtesa e Qeverisë - Rruga Nëna Tereze - Kosovë / Posta e UNMIK-ut
Секретаријат скупштинских служби - Скупштина Косова / зграда Владе - улица Мајке Терезе - Косово / Пошта УНМИК-а
Assembly Services Secretariat - Assembly of Kosovo / Government Building - Mother Theresa Street - Kosovo / UNMIK Post

# TRANSKRIPT

## I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 20 NËNTOR 2003

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës, u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës – Prishtinë.

Seancën e kryesoi Akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës. Bashkëkryesues Bajram Kosumi, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Seanca filloi punën në orën 10,10.

<u>KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:</u>

Mirëmëngjes dhe mirëseerdhët në Seancën e rregullt plenare.

Materialet e nevojshme shpresoj se ju janë shpërndarë me kohë.

Rendi i ditës po ashtu është aprovuar në seancën e kaluar dhe është verifikuar në Kryesi.

Prandaj, fillojmë menjëherë me miratimin e Procesverbalit nga seanca e kaluar.

Urdhëro...

<u>BAJRUSH XHEMAJLI:</u>

Kryesi e nderuar, kolegë deputetë,

Një dukuri po na përsëritet vazhdimisht. Edhe unë personalisht, por edhe të tjerët, kemi tërhequr vërejtjen se materialet nuk po vijnë me kohë. Po arrijnë, por

po arrijnë në momentin e fundit. Për pikën e tretë të rendit të ditës – Projektligji për kadastër ka ardhur, pothuaj në momentin e fundit, dhe dje është mbajtur mbledhja e Komisionit për buxhet që janë shqyrtuar disa amendamente dhe sot besoj kanë ardhë në momentin e fundit.

Unë mendoj se këtë dukuri duhet ta ndërprejmë për hirë të kualitetit të punës në Kuvend dhe mendoj se kjo punë duhet të shtyhet për një mbledhje tjetër të ardhshme. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Nojkiq, për procesverbal apo jo? Për çka doni fjalën? Për procesverbal mundeni, por për politikë jo.

RANDJEL NOJKIĆ:

Dame i gospodo, Radno presedništvo,

Upravo želim da govorim o zapisniku. Ja znam da mi ovde imamo različite stavove, političke, nacionalne i svake druge, i sasvim je normalno da svako zastupa svoje interese. No medjutim, nešto što je vrlo interesantno i karakteristično i nešto što mora da se poštuje a to je ono kako se izgovori da se tako napiše. Poslanici Koalicije «Povratak» su posebno uvredjeni situacijom da se kada upotrebljavamo reč «Kosovo i Metohiju» u zapisniku reč «Metohije» piše malim slovom. To je velika uvreda za sve poslanike Koalicije «Povratak» i ja vas molim da ukažete na ovome. Za vas možda to jeste smešno, ali ovo je nešto što je vrlo bitno i ja bih voleo i molio bih vas da se vi zaista na jedan korektan način odnosite prema Koalicije «Povratak». Ovako, imam utisak da sa ovakvim stavom se slažu i ovakav stav da zastupaju ne samo oni u Sekretarijatu nego i skupštinska većina. Mislim da to nije u redu. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Unë kam informatën që në transkript është mirë, ndërsa në procesverbal ndoshta do të ishte mirë me figurue vetëm - Kosova. Por këtë do ta shqyrtojmë në një mbledhje të Kryesisë sepse procesverbali është tjetër dokument, transkripti është tjetër dokument. Në transkript është ajo që ngjanë në seancë, ndërsa procesverbali dokument zyrtar i cili duhet të jetë nomenklaturë zyrtare. Megjithatë, do ta bisedojmë këtë dhe do të mirret një qëndrim. Dy vjet është tolerancë e mjaftueshme që të mbledhim mend të gjithë. Ju falemnderit.

Po vazhdojmë. Në rend dite është: - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit pë sportin.

Ëhë, më falni. Ju dëgjuat mendimin besoj të një Grupi Parlamentar për këtë çështje. Në një seancë plenare ne heqëm prej rendit të ditës një pikë për arsyera të njëjta. Prandaj, edhe në konsultime që kisha me ekipin tim para se të vij në seancë, e kam lutur që çdo material që nuk është i gatshëm deri në mbledhjen e Kryesisë, nuk është mirë të futet në seancë plenare. Unë e dij se komisionet kanë shum punë. Megjithatë, është vërtetë shumvështirë në qoftë se në ditën e seancës plenare deputeti e merr materialin, dhe këtu nuk është faji në Sekretari, ju lutem. Ne shpeshherë dhe gjithmonë po e bartim në nivele më të ulëta. Do të thotë, atë që nuk munden me arritë me kohë komisionet, unë i justifikoj, sepse ka patur punë sigurisht, por Kryesia të mos vendosë në rend të ditës diçka që nuk e ka materialin në Kryesi.

Megjithatë, unë i dua mendimet edhe të grupeve tjera parlamentare, e mos të bjen që po vendoset...

Unë mendoj se është e arsyeshme kjo që ka kërkuar deputeti, por mbetet që në seancën plenare të vendoset për këtë gjë të tillë dhe nuk është e imja, sepse Kryesia e ka vendosë në rend të ditës, prandaj seanca plenare vetëm mund ta heqë, e jo unë ose një grup parlamentar. Do të doja mendimin tuaj...

SABRI HAMITI:

S'kam çka të them kurgjë të veçantë. Unë mendoj se duhet të punojmë sipas rendit të ditës. I sygjeroj edhe Kryesisë që nëse nuk i kanë materialet t'mos i vëjë pikat në rend të dite, tjera herë. S'ka nevojë ne të bisedojmë për ato procedura. Ne i kemi ato materiale n'dorë, të dy ligjet që do t'i shqyrtojmë sot. E kemi materialin në dorë qe një ose dy ditë, jo më shumë, kështu që s'kemi nevojë të bëjmë presedane. Unë mendoj që të punojmë sipas këtij rendi të ditës, e tutje le të mendojë edhe Kryesia, edhe komisionet dhe të gjithë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Dugolli në emër të Aleancës.

BUJAR DUGOLLI:

Ne, para pak çastesh kemi pasë mbledhjen e Grupit, por nuk kemi marrë ndonjë vendim që të mos procedohet me këtë... Normalisht i bashkëngjitem vërejtjeve të kolegëve sa i përket materialeve. U tha se ndoshta është një neglizhencë edhe e punës së komisioneve që nuk i kryejnë detyrat me rregull, por kjo do të ishte një vërejtje ndoshta për Kryesinë që mos t'i futë në rend të ditës, ndërsa sot ne jemi të përgatitur të procedojmë e t'i votojmë këto. Sido që të jetë, vërejtja duhet të kuptohet që herave tjera të mos na ndodhë kështu. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Zoti Ivanoviq...

OLIVER IVANOVIĆ:

Ja se pridružujem kolegi koji je prvi govorio i koji je izneo principijelne primedbe. Mi smo razgovarali pre početka sednice i mi smo mišljenja da na ovaj način nećemo moći da kvalitetno doprinesemo, rekao bih i čitavoj diskusiji i možda usvajanju amandmana, što znači da nećemo doprineti baš ni previše ni popravljanju kvaliteta ovog zakona.

Na jednoj plenarnoj sednici ranije, sam rekao da je potrebno malo hrabrosti i malo odlučnosti u ovakvim situacijama da kažemo jedan put – ne. Ne možemo tako, jer stalno improvizujemo... Ako se samo setite, recite mi jedan zakon po kome nismo imali sličnih primedbi. Ili su u pitanju potpuno neusaglašenost zakona sa nekim prethodnim zakonima, ili su u pitanju jezičke greške, ili su u pitanju kratkoća roka. Znači, ako jednom to presećemo, ja verujem da ćemo to napraviti... da će to uticati i na nas kao Predsedništvo, i na komisije, ali i na svakog predlagača, ministre ili Vladu da nas ne dovode u poziciji da odlučujemo u situaciji kakva je ova, znači ad hok bez mnogo razmišljanja i bez - rekao bih - ozbiljne diskusije. To nije dobro za te zakone. Ti zakoni trebaju da prežive, da nadžive ovu Skupštinu. Ne da budu samo za našeg mandata, pa da nas neka sledeća skupština, izmenama i dopunama zakona menja. To nije dobro i mislim da bi mnogo bilo bolje da napravimo, kažem jednom podvučemo crtu i kažemo – e od danas nećemo više to raditi. Ako i ovaj zakon prodje nije strašna stvar, ili je još jedan u gomili koji je prošao nedovoljno pripremljen i nedovoljno diskutovan. Ali ja bih stvarno voleo da nam onda, makar ako ovaj ipak većinom prodje, sledeći zakon ne prolazi više tako. Da ga mi skidamo, budemo toliko jaki i kažemo – nije taj zakon za raspravu, nije spreman. Nema veze, neka onaj koji ga je predložio razmisli o tome kako će sledeći put pripremiti zakon. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT:

Të falemnderit. Zoti Gani Koci e kërkoj fjalën.

GANI KOCI:

Të falemnderit zoti kryetar për fjalën e dhënë. Të nderuar kolegë,

Si anëtar i Komisionit për buxhet po them ne kemi shqyrtuar këtë ligj ose amendamentet e propozuara lidhur me këtë ligj vetëm dje. Ndërsa, ne e dijmë qëndrimin e Komisionit për buxhet, por jam i bindur se 90% të deputetëve nuk kanë marrë këtë material që duhet sot këtu të shqyrtohet, do të thotë renditjen e amendamenteve e kanë marrë vetëm sot dhe jo 3-4 ditë përpara ose 3-4 javë përpara, por e kanë marrë vetëm sot. Prandaj, edhe atë që e tha edhe kryetari i Kuvendit se duhet të procedohet sipas rendit të ditës dhe sipas materialeve që dorëzohen në Kryesi. Kjo s'është bërë prandaj, kjo pikë e rendit të ditës do të duhej të shtyhej për seancën e ardhme. Vërtetë, të mos na përsëriten praktikat e të mirremi sot me materialin... Unë jam i bindur se s'i kanë në tavolinë gjysma, se s'i kanë çelë dollapët atje që i kanë, prandaj të hiqet prej rendit të ditës kjo.

KRYETARI I KUVENDIT:

Shiqoni, për rendin e ditës përgjegjësinë sot e merr Kryesia dhe kryetari. Bile, përgjegjës jam unë më tepër se të gjithë, sepse jemi marrë vesh njëherë në seancë plenare dhe nuk e kemi rrespektua atë. Prandaj, të mendojmë mirë. Mendoj se me votim ne do ta kalojmë këtë, por çfarë dobie ka në qoftë se dy grupe parlamentare kërkojnë kohë, nuk janë kundër askush, por lypin kohë për mënyrën e kontributit cilësor. Por, sipas Rregullores, në qoftë se dy grupet insistojnë unë do ta vë në votim sepse e kam për obligim, por mendimi im është që këto çështje nuk do t'i vëja në votim. Unë thash, e mora përgjegjësinë në Kryesinë dhe më tepër veten - pse është vendosë në rend të ditës, sepse nuk ka qenë i gatshëm dhe unë s'e kam pasë informatën. Informatën sot në mëngjes mua më është dhënë, kur unë s'kam pasë më mundësi ndikimi në Kryesi, prandaj dhe megjithatë është përgjegjësi e kryetarit që e kemi lejuar kështu dhe duhet të vendosë seanca plenare.

Unë do të lutja që të mos votojmë, por në qoftë se insiston...

Jo, tani duhet të votojmë a të vazhdojmë e të jetë kjo pikë në rend të ditës apo të mos jetë. Materialet nuk janë shpërndarë me kohë. Komisioni për buxhet thotë ka përfunduar punën dje. E ka fjalën Faik Marolli.

FAIK MAROLLI:

Gjithashtu edhe Grupi i të tjerëve procedon sipas rendit që është dhënë dhe në të ardhmen mos të bëhen këto që o ba deri më sot, mos ngadalësohen dhe të mos bëhen kësi mbetje. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Më lejoni që t'ju njoftoj se në seancën plenare, janë të pranishëm edhe mysafirët tanë të rrespektuar – deputetë hollandez, prandaj iu dëshiroj mirëseardhje në Parlament dhe qëndrim të këndshëm në Kosovë.

(Duartrokitje)

Unë mendoj se sipas kësaj duhet të vazhdojmë me rendin e ditës. Ose, çfarë insistoni ju, zoti profesor, të vazhdojmë me rendin e ditës kundër dy grupeve parlamentare?!

(S. Hamiti - nga vendi: Po, rrespektoni rendin e ditës!)

Ismajl Kurteshi, e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI:

Lidhur me këtë, unë e kam një propozim: Që të procedohet sipas Rregullores së punës. Rregullorja e punës e sqaron këtë punë shumëmirë, prandaj s'ka nevojë të diskutojmë. Materialet duhet 7 ditë më parë t'i kenë deputetët për të qenë të gatshëm për të punuar. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Nganjëherë, kur dikush don të ndihmojë, të bën pengesë! Unë e kuptoj qëllimin e mirë, por rendi i ditës është aprovuar në seancën e kaluar për sot. Kryesia e ka vërtetuar, duke sypozuar që materialet janë në rend të ditës. Unë po kërkoj një mirëkuptim politik, jo procedural – sepse procedurat i dijmë.

Prandaj, unë po ju lus që ta heqim prej rendit të ditës. Ta përkrahim...

Doni me vota? Atëherë, mirë.

Kush është për propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës që kjo pikë të heqet nga rendi i sotëm i ditës?

Meqë e përkraha, unë nuk mund t'i kam njëqindë qëndrime.

Të pranishëm janë 89 deputetë - 46 deputetë janë për heqjen nga rendi i ditës. Prandaj është plotësuar kushti...

(S. Hamiti - prej vendi: Po, hudhe në votimin edhe për "kundër"!)

Mirë, por vendimi është pro. 50 plus 1 - është gjithmonë vendim pro.

Mirë, kush është kundër këtij propozimi? Numëroni votat, ju lutem.

A ka abstenime?

39 vota kundër, 3 abstenime – prandaj aprovohet vendimi i parë: pika e parë e rendit të ditës shtyhet për seancën e ardhshme. Ju falemnderit.

Unë mendoj se këso votimesh do të na duheshin më shpesh dhe gjithmonë aty ku ka arsye dhe të mos i politizojmë.

Kalojmë në pikën e dytë – shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sportin.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe Kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për sportin ka bazueshmërinë juridike në Kornizën kushtetuese të Kosovës.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektlligji për sportin dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për sportin dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimet e Komisionit funksional si komision raportues dhe të Koalicionit "Kthimi".

Prandaj, po vazhdojmë.

Amendamenti 1 – Komisioni funksional.

Nuk shkruan për përkrahje. Komisionet tjera, çfarë mendimi kanë – a e përkrahin apo jo.

Komisioni për buxhet?

(H. Shatri – prej vendi: Nuk kanë implikime buxhetore!)

Ju falemnderit Haki.

Kush është për këtë amendament? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.
A ka abstenime?
16 abstenime, pa votë kundër – kalon amendamenti 1.

Amendamenti 2 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër.
A abstenon kush?
15 abstenime – kalon amendamenti.

Amendamenti 3 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemdnerit.
A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.
A abstenon kush?
15 abstenime - kalon amendamenti.

Edhe në sport, Koalicioni "Kthimi", nuk sheh interes që duhet me pasë ligj!

Amendamenti 4 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.
A abstenon kush?
5 abstenime, pa votë kundër - kalon amendamenti.

Amendamenti 5 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.
A abstenon kush?
14 abstenime – kalon amendamenti.

Amendamenti 6 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër.
A abstenon kush?
14 abstenime – kalon amendamenti.

Amendamenti 7 – Koalicioni "Kthimi" pa përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për?

...16 vota për – nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 8 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.
A abstenon kush?
14 abstenime – kalon amendamenti.

Amendamenti 9 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.
A abstenon kush?
13 abstenime – kalon amendamenti.

Amendamenti 10 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? 1 votë kundër.
A abstenon kush?
13 abstenime, 1 kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 11 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.
A abstenon kush?
13 abstenime – kalon amendamenti.

Amendamenti 12 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.
A abstenon kush?
12 abstenime – kalon amendamenti.

Amendamenti 13 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër.
A abstenon kush?
13 abstenime – kalon amendamenti.

Amendamenti 14 – Koalicioni "Kthimi" pa përkrahje nga Komisioni funksional.
Kush është për?

Po, si jo. Urdhëroni.

LJUBOMIR STANOJKOVIĆ:

Dame i gospodo, ja pre svega ovde, kako sam dobio ovaj materijal, ne mogu da vidim koji amandman se odnosi na amandmane koje smo mi od strane Koalicije podneli. Ako je ovaj amandman koji sam ja podneo ovde, u vidu člana 15. gde se odnosi na mere koje treba Ministarstvo da sprovodi u cilju poboljšanja sportskih aktivnosti, onda mogu da dam obrazloženje. A to se odnosi pre svega da treba taksativno kao odredba da se navede da je Ministarstvo dužno i da će nešto da preduzme u smislu da se poboljšaju prilike i uslovi za sportske aktivnosti nealbanskih zajednica, iz prostog razloga, valjda smo svesni toga da u ovom momentu nijedna sportska institucija, nijedan sportski teren, nijedna sportska ekipa, barem zvanična, nije dostupna pre svega barem srpskoj zajednici. I mislim da ovaj stav, ova odredba bi mogla da se donese. Možda ovde ima neke političke konotacije, ali je takva realnost. Ja ne znam..., stvarno nema razloga da se ovako nešto ne usvoji.

KRYETARI I KUVENDIT:

Unë mendoj që ligjet do t'ishte tmerrësisht gabim për parlamente ligje diskriminatore të nxjerrë, ndërsa të punohet – plotësisht pajtohem me përmbajtjen që të përmirësohen, ato çështje politike iu takojnë komunave e tjera këto, terrenet sportive, propozuesit duhet ta dijnë që iu takojnë të gjithëve. Prandaj, ne për ligjin flasim.

Megjithatë, të vazhdojmë – Amendamenti 14 Koalicioni "Kthimi" pa përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për?

Ëhë, - komisioni dëshiron... Po, si jo. Urdhëro.

MEVLYDE SARAÇI:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar kolegë deputetë dhe ju zotëri ministra,

Ne si Komision funksional kemi marrë në shqyrtim amendamentet e Koalicionit "Kthimi" dhe këtë që e kërkon për nenin 15, është përfshirë në nenin 2, që sigurisht e keni ligjin përpara dhe do ta shfrytëzoj rastin ta lexoj:

"Të gjithë personat, pa dallim moshe, gjinie, kombësie, përkatësie politike, racore, fetare dhe pavarësisht nga mundësitë fizike e mentale, pavarësisht nga niveli shoqëror ose ekonomik i tyre – e gëzojnë të drejtën e marrjes me veprimtari sportive". Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit shumë, dhe bëtë mirë që u paraqitët.

Prandaj, edhe një herë vë në votim Amendamentin 14 – Koalicioni "Kthimi" pa përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për?
15 vota për – nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 15 – Koalicioni "Kthimi" pa përkrahje nga Komisioni funksional.

(Prej vendit: Mogu li opet ja...?)

Si të jetë sqarim politik, të lutem – jo.

(Prej vendi: Šta ima veze? Ima pravo...!)

Ti atje, mos më mëso kush ka të drejtë e kush s'ka, Nojkiq. Nuk je ti interpretues i ligjit këtu. Jo, jo – shkon përjashta, herën tjetër!

LJUBOMIR STANOJKOVIĆ:

Ja ne mogu da shvatim. Ja sam mislio da smo ovo na Funkcionalnoj komisiji usvojili, a sada se ovde pojavljuje da nije podržan od strane Funkcionalne komisije. Ne mogu da shvatim. I ovde, nema politike – gospodine Daci. U pitanju je jezička stvar. Umesto "sportske federacije" na srpskom je "sportski savez", to je valjda svima jasno ko malo zna srpski, to zna da je tako. Ja mislim da je od strane Funkcionalne komisije ovo podržano.

KRYETARI I KUVENDIT:

Edi Shukriu e ka fjalën.

EDI SHUKRIU:

Zoti kryetar, deputetë të nderuar,

Ne, në Komision për kulturë, rini dhe sport, do të thotë jemi marrë vesh që çështjet gjuhësore që i takojnë njërës gjuhë apo tjetrës, të rregullohen. Prandaj, në parim jemi pajtuar për këtë ndryshim. Për Komisionin nuk ka fare problem. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Do të thotë ... Urdhëroni.

SABRI HAMITI:

O ju lutem shumë, nuk është kaq i thjeshtë ky problem. Nuk është krejt qysh po thotë zonja Edi. Dallimi është substancial ndërmjet "lidhje" e "federatë". E dijnë shummirë edhe organizatat e sportit, edhe Ministria, edhe zotnia që e propozon dhe "Koalicioni". Janë dy nivele organizimi që nënkuptojnë tipe krejt të ndryshme organizimi, prandaj përkthimi s'mund t' bëhet. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Profesor, ju falemnderit shumë. Dhe procedojmë sipas... Zoti Ivanoviq si anëtar i Kryesisë.

OLIVER IVANOVIĆ:

Bez namere da polemišem, ali ja sam slušao gospodju Edi koja govori o Komisiji, s kakvim pravom bilo kod... Ona govori o Komisiji, o zaključku Komisije. Principijelni zaključak Komisije je bio da se po pitanju jezičkih problema usvaja, znači jezička terminologija... Oni se po tom pitanju složili, na konstataciju koju je Ljubo upravo izneo. Znači, nemojte da nam neko tumači sa strane, uz svo poštovanje, i vaše Parlamentarne grupe i šefa Poslaničke grupe, da nam tumači sada stavove Komisije i da tumači da li je Komisija bila u pravu ili nije u pravu. Potpuno je nevažna stvar... Znam ja dobro... Toliko dobro znam i albanski da znam šta znači «federata» a šta znači «lidhja», ali nije stvar u tome da mi sada tumačimo... mi leksički ili jezički tumačimo šta je stav Komisije.

Gospodja Edi je ovde iznela stav Komisije, i za nas je relevantan stav Komisije, a ne da li je Komisija bila u pravu ili ne.

(S. Hamiti – prej vendi: Komisioni s'e ka përkrahë!?)

Komisioni e ka përkrah! Nije tako! Ja sam razumeo odlično šta je gospodja rekla. Rekla je da u toj situaciji kao jezičko pitanje prihvatila sugestiju. A vi niste bili na komisiji, kao ni ja.

(polemikë nga vendi)

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju lutem, s'ka nevojë... Ju lutem, procedojmë me rregull.

E vë në votim amendamentin 15 Koalicioni "Kthimi" pa përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për?
15 vota për – nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 16 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Ju falemnderit.
A abstenon kush? Nuk ka abstenime.
14 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 17 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Ju falemnderit.
A ka abstenime?
15 vota kundër, nuk ka abstenime – kalon amendamenti.

Amendamenti 18 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Ju falemnderit.
A ka abstenime? Nuk ka abstenime.
15 vota kundër - kalon amendamenti.

Amendamenti 19 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka kush kundër? Ju falemnderit.
A abstenon kush? Nuk ka abstenime.
15 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 20 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Ju falemnderit.
A ka abstenime? Nuk ka abstenime.
15 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 21 – Koalicioni "Kthimi" pa përkrahje nga Komisioni funksional.

Urdhëroni, mundeni...

LJUBOMIR STANOJKOVIĆ:

Moram da vam priznam, da posle odbijanja onog amandmana, ne vredi čovek ni da ovde nešto dalje predlaže i da se za nešto zalaže. Ali, primamo platu pa valjda moramo i te stvari da radimo, za koje - znam unapred - da su osudjena na propast.

Ovde se radi o tome da treba Kosovski olimpijski komitet da stoji. Naš je stav da ne treba. Znate, kada se zakon donosi, po mome mišljenju, po mome nekom saznanju svaki zakon treba da omogući, da olakša, da se nešto bolje radi, da neko više radi. Znate sportski vek je pet do deset godina. Sportski vek nije pedeset, nije sto godina. Ako u tih pet do deset godina sportistima ne omogućimo da se takmiče, nemamo više kada da im omogućimo. Realnost je u ovom momentu takva. Dajte, mislim nemojte da se i u sportu bavimo previše politikom i da sportisti zbog toga pate. Što više insistiramo na ovakve državne

elemente i u zakonu o sportu sportisti sa Kosova se neće takmičiti. Mislim, ako brišemo ovo, biće mnogo lakše da se sportisti sa Kosova takmiče van Kosova. A vi tumačite kako god hoćete...

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit. Lubo, ju falemnderit për kontribut...

Edhe një herë – amendamenti 21 Koalicioni "Kthimi" pa përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.
A ka abstenime? Nuk ka abstenime.
14 vota për – nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 22 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Ju falemnderit.
A ka abstenime?
13 vota kundër, nuk ka abstenime – kalon amendamenti.

Amendamenti 23 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Ju falemnderit.
A ka abstenime?
14 vota kundër, nuk ka abstenime – kalon amendamenti.

Amendamenti 24 - Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka abstenime, 14 kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 25 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Ju falemnderit.
A ka abstenime?
Nuk ka abstenime, 14 vota kundër - kalon amendamenti.

Shpresojmë se në dhjetor do ta kemi votimin elektronik dhe të mos lodhemi më mekanikisht, sepse kjo me të vërtetë na zgjati shumë.

Amendamenti 26 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
Kush është kundër? Ju falemnderit.
A ka abstenime?
2 abstenime, 14 kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 27 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Ju falemnderit.
A ka abstenime?
13 vota kundër, nuk ka abstenime – kalon amendamenti.

Amendamenti 28 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Ju falemnderit.
A ka abstenime?
Nuk ka abstenime, 14 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 29 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?
A ka abstenime?
14 vota kundër, nuk ka abstenime – kalon amendamenti.

Amendamenti 30 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Ju falemnderit.
A ka abstenime?
Nuk ka abstenime, 14 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 31 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?
A ka abstenime?
14 vota kundër, nuk ka abstenime – kalon amendamenti.

Amendamenti 32 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Ju falemnderit.
A ka abstenime?
Nuk ka abstenime, 14 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 33 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Ju falemnderit.
A abstenon ndokush?
Nuk ka abstenime, 14 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 34 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka abstenime, 14 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 35 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
Kush është kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka abstenime, 13 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 36 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka abstenime, 14 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 37 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka abstenime, 13 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 38 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka abstenime, 14 vota kundër – kalon amendamenti.

A rregulloren don me sqarue, a? Hydajet Hyseni, si anëtar i Kryesisë.

HYDAJET HYSENI:

As nuk do ta sqaroj rregulloren, madje as nuk do të përgjigjem në do batuta që po i dëgjoj herëpashere, por mendoj se do sqaruar një çështje. Amendamenti që sapo e aprovuam ndryshon pjesën e parë të nenit, por nuk thotë gjë për pjesën e

dytë – shlyhet ose jo, kurse kjo ka pastaj konsekuenca konkrete lidhur me sportin amator. Kërkoj që Komisioni s'paku ta sqarojë që të mos mbetet e paqartë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Të falemnderit.
Amendamenti 39 – Komisioni funksioinal.
Kush është për? Ju falemnderit.

E votuam Hydajet. Është dashur para se ta votojmë... Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Ju falemnderit.
A ka abstenime?
Nuk ka abstenime, 14 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 40 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka votë abstenimi, 13 kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 41 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?

Para se të votojmë, a? Urdhëro, të lutem.

MEVLYDE SARAÇI:

Në amendamentin 41, një gabim teknik është. "Konfliktet lidhur me rrespektimin e kontratave në mes të klubeve sportive, nëse nuk zgjidhen përmes federatave", duhet të jetë "përkatëse zgjidhen nga gjykatat kompetente", sepse ky gabim teknik ia ndërron kuptimin tërë fjalisë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Edhe një herë. Amendamenti 41, me këtë përmirësim të germës, përmirësim teknik. Për "pro" kemi votuar.

A ka votë kundër? Ju falemnderit.

A ka abstenime?
Nuk ka votë të abstenimit, 13 kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 42 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka votë abstenimi, 12 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 43 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
Kush është kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka kabstenim, 13 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 44 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka votë abstenimi, 13 janë kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 45 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka votë abstenimi, 12 vota kundër – kalon amendamenti.

Urdhëroni, Edi...

EDI SHUKRIU:

Ju falemnderit. Na falni për aq shumë amendamente, por kemi qenë të detyruar. Zoti kryetar, që të mos jetë ligji i mangët, ju kisha lutur ta keni parasysh dhe mbase të kthehemi në amendamentin 38 se zoti Hydajet kishte të drejtë, kështu është bërë një gabim. I 38-ti. Neni 41 është dashur të jetë "të riformulohet pasusi i parë". Zotëri Hydajeti kishte të drejtë, se në qoftë se shkon amendamenti e s'u aprovua, atëherë nuk ngelë pasusi i dytë. Këtu është dashur të jetë "neni 41 riformulohet pasusi i parë", ndërsa ngelë pasuesi i dytë. Prandaj, edhe kemi kërkuar që të bëhen me pika, domethënë secili nen. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju falemnderit shumë, por sipas procedurës ne e kemi votuar, i ka marrë votat, prandaj është vonë. Do të duhej të bëhej me kohë dhe sigurisht se do ta kishim... Do të thotë mbetet për ndonjë procedurë tjetër të ligjit, ose le të vendosë seanca plenare, e jo unë...

(Pas reagimit prej vendi)

Ju falemnderit, pra.

Amendamenti 46 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?
A ka abstenime?
12 vota kundër, nuk ka abstenime – kalon amendamenti.

Amendamenti 47 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër? Ju falemnderit.
A ka abstenime?
Nuk ka votë abstenimi, 13 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 48 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka votë abstenimi, 12 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 49 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
Kush është kundër?
A ka votë abstenimi?
Nuk ka votë abstenimi, 13 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 50 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka votë abstenimi, 12 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 51 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka votë abstenimi, 11 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 52 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka votë abstenimi, 10 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 53 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka abstenime, 12 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 54 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
Kush është kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka abstenime, 12 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 55 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
Kush është kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka votë abstenimi, 13 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 56 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka votë abstenimi, 12 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 57 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
Kush është kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka votë abstenimi, 12 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 58 - Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?
A ka abstenime?

Nuk ka votë abstenimi, 12 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 59 – Koalicioni "Kthimi" pa përkrahje nga Komisioni funksional.

Urdhëroni...

LJUBOMIR STANOJKOVIĆ:

Ovde sam hteo, barem kad sam dao predlog ovog amandmana, s obzirom da, ipak na Kosovo ima previše nas pa čak mislim više nego bilo gde drugde, ovaj... da bi smo zaštitili pripadnike Kosovske policijske službe koji oni uglavnom sada regulišu red i mir po sportskim objektima, da u ovim jačim neredima svoje učešće imaju specijalne policijske snage. Ovoga ima svuda, ne samo..., u stvari ne samo... ima svuda a izgleda ima jedino na Kosovo. Moj je cilj bio, znači, da zaštitim KPS, ništa drugo.

KRYETARI I KUVENDIT:

Ju lutem, dëgjuam arsyetimin.

Edhe një herë – amendamenti 59 Koalicioni "Kthimi" pa përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për?
13 vota për – nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 60 – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
Kush është kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka votë abstenimi, 12 vota kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 61, i fundit – Komisioni funksional.
Kush është për? Ju falemnderit.
A ka votë kundër?
A ka abstenime?
Nuk ka abstenime, 13 vota kundër – kalon amendamenti.

Ju falemnderit për kontribut. Tani duhet ta votojmë ligjin në tërësi, me amendamentet e aprovuara.

Kush është për? Ju falemnderit shumë.

A ka votë kundër?
A ka abstenime?

Pa votë abstenimi, me 13 vota kundër – konsideroj se ligji i shqyrtuar është aprovuar. Ju falemnderit shum.

Në sallë gjatë votimit kanë qenë 85 deputetë.

---

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For .........................Shumica – Vecina – Majority...........
- Kundër – Protiv – Against .........................13...................
- Abstenime – Uzdrzani – Abstaned.............00.....................

---

(Duartrokitje)

Ju falemnderit shumë. Mendoj se kemi merituar një pauzë njëzetminutëshe. Vazhdojmë pas 20 minuta të kësaj pauze.

(Vijon pauza)

(Pas pauzës, seanca vazhdoi punën)

Në vazhdim Seancën plenare e kryesoi bashkëkryesuesi Bajram Kosumi, anëtar i Kryesisë së Kosovës.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Të nderuar deputetë, po vazhdojmë punën. Lus deputetët të zënë vendet e tyre dhe lus për koncentrim dhe pak më qetësi në sallë.

Vazhdojmë me pikën vijuese të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Projektligjit për transportin rrugor numër 2003/32.

Më lejoni t'ju njoftoj se Projektligji iu është shpërndarë deputetëve me 30 tetor 2003 kështu që janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim.

Sot këtu është prezent ministri, zoti Zef Morina për të paraqitur ekspozenë dhe ne pastaj do të zhvillojmë debatin në parim për Projektligjin në fjalë.

Zoti ministër, urdhëroni.

ZEF MORINA:

I nderuari kryesues, Kryesi e nderuar, zonja dhe zotërinj deputetë, kolegë ministra,

Projektligji i propozuar mbi transportin rrugor është një ndër prioritetet më të larta të Ministrisë së Transportit dhe Postelekomunikacionit. Ky Projektligj është përgjigje ndaj nevojave për një ligj moderrn për sektorin e transportit rrugor, të udhëtarëve dhe mallrave, nevojë e të cilave janë identifikuar si disa nga prioritetet më të larta të Ministrisë për krijimin e legjislacionit për këtë vit.

Ky Projektligj promovon konsolidimin e strukturave përgjegjëse në sektorin e transportit rrugor për arsye se sqaron përgjegjësitë dhe kompetencat përkatëse të subjekteve që janë përgjegjëse në sektorin e transportit rrugor, zhvillimit të transportit të udhtarëve dhe të mallrave.

Ky Projektligj ngritë nivelin e transparencës dhe efikasitetin në sektorin e transportit. Ministria e Transportit do të krijojë dhe implementojë politikën dhe strategjinë e sektorit të transportit rrugor të miratuar nga Qeveria në bazë të procedurave transparente të cekura në Projektligjin në fjalë.

Ligji mbi transportin rrugor është i nevojshëm me sa vijon:

Me qëllim të rregullimit të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, si dhe të zhvillimit normal e të sigurtë të transportit në rrugët publike të Kosovës. Në bazë të standardeve ndërkombëtare si dhe normativave që kanë të bëjnë me këtë sektor, është i domosdoshëm plotësimi i zbraztësirës së krijuar vite me radhë në lëmin e transportit rrugor, i cili sektor është segment shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe ecjen përpara të shoqërisë në Kosovë, mbi të cilën mbështeten kornizat e rregullimit të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave. Ky ligj siguron ofrimin e shërbimeve të transportit; përmirësimin e cilësisë së shërbimit si dhe mbrojtjen e përdoruesve të këtyre shërbimeve; zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori dhe atë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kushtet konkrete të zhvillimit të kësaj veprimtarie;

licencimin e operatorëve publik të cilët ofrojnë kryerjen e shërbimeve të transportit rrugor publik; dhënien e lejeve operatorëve vendor, të cilët dëshirojnë të kryejnë transport jashtë Kosovës dhe operatorëve të huaj që gjatë kryerjes së transportit rrugor të udhëtarëve apo të mallrave kanë qasje në territorin e Kosovës.

Ky ligj arrin që me kompetencë të përcaktojë problemet që i referohen transportit rrugor të udhtarëve dhe mallrave si dhe krijon kushte për rregullimin dhe mbikëqyrjen e kësaj veprimtarie.

Ky ligj përcakton kompetencat e Ministrisë, komunave dhe të drejtat e obligimet e operatorëve si ofrues të shërbimit dhe përdoruesve të këtyre shërbimeve.

Ky ligj përcakton kompetencat e Ministrisë për hartimin e strategjisë dhe zhvillimit të transportit, e cila pastaj i paraqitet Qeverisë për miratim.

Projektligji përbëhet nga disa krerë.

Kreu i parë – dispozitat e përgjithshme, përfshijnë lëndën e rregullimit, qëllimin dhe fushën e zbatimit të tij; përkufizimet, përgjegjësitë e institucioneve të vetëqeverisjes, përgjegjësitë e operatorëve të transportit që ushtrojnë këtë veprimtari në territorin e Kosovës; mënyrën dhe kushtet e lëshuarjes së liçencave dhe lejeve operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor.

Kreu i dytë – transporti rrugor i udhëtarëve, precizon llojin e transportit rrugor të udhëtarëve. Në mënyrë të veçantë definon kompetencat dhe përgjegjësitë në nivel qendror dhe lokal, përkatësisht duke përcaktuar se Ministria është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit të rastit të udhëtarëve me autobus, transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus, si dhe transportit ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus. Ndërsa përcakton që komuna është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit urban të rregulltë të udhëtarëve me autobus dhe me transport taksi të udhëtarëve.

Kreu i tretë – transporti rrugor i mallrave, përcakton mënyrën dhe kushtet e kryerjes së këtij lloji të transportit, si: transporti i mallrave për nevoja personale dhe transporti i mallrave me qera dhe pagesë. Liçencat lëshohen për një periudhë pesëvjeçare, ndërsa për transportin e jashtëm Ministria përcakton dhe shkëmben numër të nevojshëm lejesh për një vit me organet kompetente të shteteve tjera. Shpërndarjen e lejeve të huaja të transportuesve vendës e bën Ministria me ç'rast emëron komisionin për shpërndarjen e lejeve jashtë Kosovës, definon kompensimin për shpërndarjen e këtyre lejeve, dhënien e lejeve të posaçme për hyrje në Kosovë në qoftë se transportuesi i huaj është nga shteti me të cilin Kosova nuk ka lidhje kontratash apo marrëveshjesh; ndalon

hyrjen në Kosovë të të gjithë operatorëve pa leje të posaçme për hyrje në Kosovë përveç operatorëve transportues të cilët posedojnë lejen e "cenkit" dhe lejet bilaterale; përcakton rastet për të cilat nuk nevojiten lejet.

Kreu i katërtë – mbikëqyrja dhe kontrolli në transportin rrugor, definon mënyrën dhe kushtet e mbikëqyerjes dhe kontrollimit mbi zbatimin e këtij ligji dhe akteve tjera të nxjerra në bazë të tij, kompetencat e inspektorit të transportit me rastin e kontrollimit të operatorëve dhe masat që do t'i ndërmarrë në qoftë se konstaton se transporti nuk është duke u zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore; përcakton bashkëpunimin e inspektorit të transportit me Shërbimin Policor të Kosovës në mënyrë që sipas kompetencave që kanë, në koordinim të ndërmarrjes së masave për eliminimin e parregullsive.

Gjithashtu Projektligji definon kompetencat e oragneve të kontrollit kufitar me rastin e hyrjes së automjeteve të transportit rrugor në Kosovë apo të daljes prej saj.

Dispozitat ndëshkimore – përcaktojnë kundërvajtjet administrative dhe masat e gjobitjes.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare – hyrja në fuqi e këtij ligji.

Ligjet tjera për këtë çështje. Nuk ekzistojnë ligje tjera përveç ligjit mbi transportin në komunikacionin rrugor "Gazeta Zyrtare e Kosovës" nr. 5/82. Domethënë nga legjislacioni i Ish-jugosllavisë i cili ligj është i tejkaluar dhe është në kundërshtim me sistemin e ri juridiko-politik dhe me standardet e avancuara ndërkombëtare në transportin rrugor.

Ministria në hartim të këtij ligji është mbështetur në kapacitetet profesionale që disponon, ndihmën e konsulentit dhe këshilltarit ligjor nga UNMIK-u pranë Ministrisë së Transportit që të përpilojë këtë Projektligj.

Koordinimi me UNMIK-un. Ministria dhe zyra ligjore e UNMIK-ut kanë analizuar çështjet e kompetencave të transferuara dhe të rezervuara në fazën e hershme të hartimit të Projektligjit në fjalë; dhe

Koordinimi me ministritë tjera. Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacinit, me rastin e hartimit të Projektligjit ka bashkëpunuar me Ministrinë për Ekonomi e Financa, Ministrinë e Shërbimeve Publike, Shërbimin Policor të Kosovës ku kanë qenë të përfshirë në Grupin punues për shqyrtimin e Projekligjit në fjalë nga një anëtar i ministrive për çështje që prekin kompetencat e ministrive përkatëse. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Të falemnderit zoti ministër. Të nderuar deputetë, po hapim debatin për Projektligjin për transportin rrugor. Debati do të bëhet në parim, pa u lëshuar në detaje, do të thotë në sygjerime, vërejtje, apo konstatime parimore për Projekligjin. Diskutuesit do të radhiten sipas Rregullores, së pari kryetarët e komisioneve, pastaj shefat e grupeve parlamentare dhe deputetët që janë paraqitur.

Thërras të marrë fjalën Mahir Jagxhillar, në emër të Komisionit për transport.

MAHİR JAĞCILAR:

Të falemnderit zoti kryesues,

**Sayın Başkan, Sayın Bakanlar, değerli millet vekilleri**

Bugün önümüzde Kosova için önemli olan bir Kanun daha bulunmaktadır, o da Karayolu Ulaşımına ait Kanundur. Bu Kanunun amacı, operatörler-sürücüler arasındaki ilişkileri düzene koymak ve Kosova vatandaşlarına ulaşım hizmetlerini sunmaktır.

Ulaşım Komisyonu bu Kanunu genelde görüştü. Komisyonun düşüncesine göre, ulaşım alanı bu alandaki gereken kanunlarla hala kapsanmadığı için, sözkonusu Kanuna oldukça büyük gereksinim duyulmaktadır.

Bu Kanunun getirilmesiyle, yolcu ile mal ulaşımı düzene girecek, sağlam rekabet sağlanacak, hizmetler kalitesi artacak ve karayolu ulaşımında güvenlik ile başarı derecesi artmış olacaktır.

Ortaya atılan bazı uyarılar yanı sıra Komisyon, bu Kanunun genelde kabul edilir olduğunu ve Kosova Meclisinde görüşülebileceğini düşünmektedir.

Komisyon tarafından yapılan uyarılara göre, bu Kanun Tasarısı, 8+1 koltuklu " Taksi " taşıtları ulaşımına çözüm vermiyor. Düşüncemize göre bu sorun, Kanundışı akitler ve belediyelerin kararlarıyla değil, bu Kanunla çözümlenmelidir. Bugün Kosovada yolcuların sıralı ulaşımını sağlayan yaklaşık bin minibüs taksi şoförü vardır, eğer bunlar için gereken çözümler bulunmazsa, o zaman ileride bunlar güçlü sosyal sorunu oluşturmuş olacaktır. Fakat, aynı zamanda bunların otobüs yolculuğu ile aleni ulaşımı gayrilegal engelemelerine izin vermemeliyiz.

Bu Kanunda aynıca 15. maddede yer alan ruhsatların verilmesi koşulları da saptanmamıştır.

22.6, 11.2 ve 26.1 maddeleri arasında da anlaşmazlıklar mevcuttur. Bu maddelerde seferlerin kiraya verilmesi ve borçların aktarılması yasağından söz edilmektedir. Eğer bu Kanunla, pratikteki sürücülerin sorumlulukları ve görevleri saptanmazsa, o zaman Kanunun uygulanmasında sorunlar meydana gelmiş olacaktır.

Düşüncemize göre Kanun hükümlerinde, aleni ulaşım taşıtlarında bulaşıcı hastalıktan hasta olan kişilerin, alkol ve esrar kullananların, hayvanların ve patlayıcı maddelerin yer almasının yasak olduğunun belirtilmesi gereklidir.

Aynı zamanda bu Kanunda, olağanüstü koşullardaki ulaşım şartları saptanmamıştır.

Şunu da belirtmek isterdik ki, Kanunun başarıyla uygulanması amacıyla, bu Kanun esasınca getirilmesi gereken Kanundışı akitlerin listesi verilmeli ve bunların aynılarının getirilmesi süreleri saptanmalıdır. Örneğin, Ruhsatlarla ilgili Yönetmelik, Otobüs istasyonlarına ait Yönetmelik, Yolculukla ilgili Yönetmelik, Taşıtların teknik eksploatasyon koşullarına ait Yönetmelik vb.

Düşüncemize göre, aleni okunuştan ve değiştirgelerin sunulmasından sonra, Kanun zenginleşecek , ortaya atılan zayıflıklar ortadan kalkacak ve aynı zamanda gereken şekilde pratikte uygulanmış olacaktır. Bununla birlikte, Karayolu ulaşımı da Kosova vatandaşları ve Kosovada yolculuk yapanlar için daha güvenli olacaktır.

Değerli millet vekilleri, herkes için çok önemli ve gerekli olan Karayolu ulaşımına ait Kanunu genel olarak kabul etmemiz için bir kez daha çağrıda bulunuyorum.

İlginize teşekkürler. Ju falemnderıt.

<u>KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:</u>

Të falemnderit deputeti Jagxhillar. Fjalën e ka deputeti Ilmi Ahmeti, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

ILMI AHMETI:

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë dhe ministra,

Projektligji për transportin rrugor, të mallrave dhe udhëtarëve, për të cilin po debatojmë sot në parim – është i një rëndësie të veçantë.

Ky Projektligj, në mënyrën më të mirë zgjedh të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me transportin e udhëtarëve dhe të mallrave si brenda Kosovës, ashtu edhe jashtë saj. Kosovës i ka mungaur një ligj i tillë, i cili rregullon këtë lloj transporti, sidomos tash kur janë shtuar nevojat për transportin rrugor, të njerëzve dhe të mallrave dhe për arsye të mungesës së transportit hekurudhor. Ky Projektligj është mjaft përmbajtësor, mjaft i qartë dhe në mënyrën më të mirë zgjidhë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë lloj të transportit.

Komisioni funksional e ka vlerësuar si ligj që duhet përkrahur në parim, me disa korrigjime të vogla.

Mendojmë se çështjet e transportit të jashtëzakonshëm, të transportit të veçantë dhe të transportit me kombibus do të duhej të rregulloheshin me nene të veçanta, sidomos këto dy të fundit - transporti i veçantë i cili është me interes për Kosovën, si transporti i mallrave me vlerë, pasurive shtetërore e tjera. Çështje mjaft e rëndësishme është transporti i udhëtarëve me kombibus, e që ky Projektligj do ta zgjidhë në bashkëveprim me pushtetin lokal, ku komunave iu jipen mundësi që të rregullojnë transportin e udhëtarëve dhe mallrave në nivel lokal dhe se në kuadër të saj do të zgjidhet ky lloj transporti me këto lloj automjetesh.

Projektligji në fjalë dhe ligjet tjera që do t'i miratojë ky Kuvend, si ligjin për transportin e mallrave të rrezikshme dhe ligjin për sigurinë në komunikacion do ta rrisin sigurinë e transportit rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave. Projektligji do të ndalojë transportin e njerëzve dhe mallrave në mënyrë të pakontrolluar. Projektligji obligon që të gjithë operatorët e transportit të udhëtarëve dhe mallrave më parë duhet të pajisen me licencë.

Ne, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, përkrahim këtë Projektligj dhe ftojmë edhe deputetët tjerë që ta votojnë në parim. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Ju falemnderit deputet Ilmi Ahmeti. Fjalën e ka deputetja Sala Ahmetaj, në emër të Partisë Demokratike.

SALA AHMETAJ:

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë dhe të nderuar ministra,

Kosova po ballafaqohet me shumë të këqia, e një ndër to është edhe kaosi që po mbretëron gjatë transportit të mallrave dhe të udhëtarëve, edhe për faktin se na mungonte infrastruktura ligjore. Prandaj, nxjerrja e këtij ligji dhe e nënligjeve tjera që do të duhej ta rregullonin këtë sferë është ndër çështjet parësore që shtrohen para nesh. Sepse, shpresojmë dhe duam të besojmë se me këtë ligj do të shmangen shëmtitë, shpërfilljet dhe parregullsitë e shumta që i shohim çdoditë në rrugët tona dhe kudo tjetër. Duam të besojmë se anarkia do të pushojë së qenuni pas miratimit dhe vënies në jetë të këtij ligji.

Shikuar nga aspekti përmbajtësor dhe strukturor, kujtojmë se ligji është hartuar mirë dhe me një gjuhë të kuptueshme relativisht të kënaqshëm. Natyrisht, ne do të flasim më shumë për mangësitë dhe paqartësitë eventuale me qëllim që ai të bëhet më i përkryer.

Ndër vërejtjet më serioze që do t'ia bënim këtij ligji dhe që shpresojmë se komisionet përkatëse do t'i kenë parasysh – janë tek roli i Ministrisë në sektorin e transportit dhe funksioni i saj. Kemi vënë re se kompetencat kryesore për çështje parësore dhe më të rëndësishme në këtë Projektligj i ka ministri. Ne do të parapëlqenim ndarjen e përgjegjësive dhe kompetencave, për shembull, me grupin e ekspertëve, me drejtues të sektorëve të ndryshëm, sepse kemi frikë se lënia e çështjeve të rëndësisë madhore në duar të vetëm një njeriu do të lejojë mundësinë për byrokratizim dhe keqpërdorim. Natyrisht, ne nuk paragjykojmë për ministrin aktual, por duhet të jemi të vetëdijshëm se Kosova nuk është Suedi ku ndërgjegjësimi i individit është në lartësinë më të lakmueshme të mundshme, kurse në Kosovë standardet më të rëndësishme që duhet t'i ndërtojmë dhe kultivojmë së brendshmi, domethënë ne për vetëveten – janë ndërregja më e lartë dhe rrespektimi i ligjit.

Kur t'i përmbushim këto standarde, individi mund të marrë përgjegjësi më të mëdha. Tani për tani jemi larg së të dëshiruares.

Këtu kemi të bëjmë, për shembull me nenin 11, 16, 20, 22.4, 47.2, 58.2, e tjerë dhe për të dëshmuar këtë, do të lexoj vetëm një, te neni 11.4: "Kriteret, rregullat dhe dokumentacioni për dhënien e licencës dhe lejes përcaktohen me akt të veçantë juridik që e nxjerr ministri". Kujtojmë se këtë dhe çështjet tjera do të duhej të shtroheshin më ndryshe, domethënë ministri do të duhej të kishte më shum funksion politik, kurse aktet juridike i bën grupi i ekspertëve ose përgjegjësit e sektorëve të caktuar që do të duhej t'i bënin.

Shumë gjëra në Projektligj janë thënë në mënyrë përgjithësuese, pa saktësime dhe pa kritere të precizuara. Ligji, e dijmë, duhet të qartësojë dhe të normojë më mirë se ç'është e lejueshme dhe çfarë nuk është e lejueshme, ose të jenë më të qartësuara kriteret rreth licencimit e tjera.

Vërejtja tjetër që kemi, është se ndonjëherë duken të paqarta marrëdhëniet në mes nivelit të parë dhe nivelit të dytë. Niveli i dytë, në disa raste do të duhej të kishte më shumë kompetenca dhe përgjegjësi. Në sistemet komuniste ka vendosur vetëm qeveria qendrore, domethënë niveli i parë. Demokracia do të nënkuptonte më shumë kompetenca për qeveritë lokale.

Të menduarit dhe të vepruarit në mënyrë homogjene përjashton të menduarit ndryshe dhe mundësinë e shfaqjes së kreativitetit dhe konceptit të objektivitetit. Disa nene janë shkruar me një gjuhë të paqartë. Nuk flasim me këtë rast për lekturë as për kulturë gjuhe. Për shembull neni 56.b ose 54.3 është gabim logjik ose i përkthimit. Për shembull, thotë: "shpërndarjen e lejeve të huaja". Unë kujtoj se këtu ka të bëjë me dhënien e lejeve, e jo shpërndarjen.

Ajo që është e rëndësishme dhe e mirë në këtë ligj, është që parashihen dispzitat ndëshkuese dhe kalimtare, që ndihmojnë në zbatimin e ligjit. Një praktikë e tillë është mirë të përfillet nga të gjitha ministritë me qëllim që ligjet e Kosovës të jenë unike me standarde dhe të kenë një sistem homogjen juridik.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i jep mbështetje parimore këtij ligji dhe shpresojmë se në shqyrtimin e mëtutjeshëm të komisioneve ky ligj do të plotësohet me vërejtjet e nevojshme me qëllim të përkryerjes së tij.

Ju falemnderit për vëmendjen.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Të falemnderit zonja Ahmetaj. Fjalën e ka Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës.

NAIM MALOKU:

I nderuari zoti kryesues, të nderuar ministra, deputetë të nderuar,

Më lejoni që, në emër të Grupit Parlamnetar të Aleancës, të jap vërejtjet që i ka ky Grup Parlamentar në këtë ligj.

Ligji për transportin rrugor është i një rëndësie, edhe unë po e potencoj, të veçantë për Kosovën për faktin se ky ligj mënjanon apo rregullon një kaos - kisha me thënë - që mbizotëron në transportin rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave në territorin e Kosovës.

Gjatë përpilimit të këtij ligji, mendimi ynë është, se ka munguar një projeksion i këtij ligji në praktikë – pra si do të dukej apo si do të implementohej dhe çfarë komplikimesh do të sillte ky ligj i formuluar kështu gjatë implementimit në praktikë.

Më lejoni që këtë mendim timin ta mbështes me disa fakte:

Neni 39.2 parasheh mënyrën e transportit të udhëtarëve me, të ashtuquajturit kombibus apo taksi 8 plus 1, që është me këtë ligj kompetencë e komunës. Mirëpo, ky nen bjen ndesh me nenin 42, ku, për shembull, drejtuesit e automjetit taksi nuk mund të qëndrojnë e as të marrin udhëtarë në territorin e komunës ku nuk janë të regjistruar – një. Dhe, me nenin që e ndalon, për shembull, përdorimin apo linjat e këtyre kombibusëve, që po e marrim për shembull – Prishtinë – Fushë-Kosovë, Prishtinë – Obiliq, Prishtinë-Podujevë. Pra ky lloj transporti hyn pastaj në domenin e Ministrisë që është e përcaktuar në nenin 19.a) ku thotë se për transportin ndërurban vendosë Ministria. Pra, këto janë disa kompetenca që duhet të qartësohen gjatë shqyrtimit të këtij ligji.

Neni 39.2, është shumë interesant se vjen në shpërputhje edhe me nenin 41 - 41.2, pika e fundit ku thotë: taksi nuk mund të shfrytëzoj vendndaljet e dedikuara për autobus. Pra, kemi parasysh kombibusët në qytetin e Prishtinës, nuk mund t'i shfrytëzojnë vendndaljet e autobusëve urban. Thjeshtë, ishte dashur pastaj komuna të bëjë dhe formojë vendndalje tjera. Pra, kjo duhet të qartësohet dhe të rregullohet mirë gjatë procedimit të mëtutjeshëm të këtij ligji.

Më lejoni ta përuroj Ministrinë për tentimin që të ketë rregull në transportin e mallrave – transportin ndërkombëtar, që janë të sanksionuara në ligj me nenet 53 deri në 60. Por, këtu mungojnë lejet transite, të ashtuquajtura, jo vetëm të transportit jashtë Kosovës, siç është me nenin 53 nën a) për transport brenda Kosovës, për transport jashtë Kosovës dhe duhet të jetë edhe për transportin transit nëpër territorin e Kosovës. Lejet transite janë zakonisht objekt i diskutimeve dhe marrëveshjeve reciproke me shtetet. Kryesisht janë leje transite ato që Ministria në marrëveshje me shtetet tjera i favorizon transportuesit e brendshëm të Kosovës dhe bëhet ajo marrëveshje e reciprocitetit, pra sa leje transiti i jipet, për shembull Serbisë për në territorin e Kosovës, apo Maqedonisë për transit në Maqedoni, Mal të zi apo anasjelltas aq leje i jipen edhe transportuesve vendor për mallra transite nëpër territorin e atyre shteteve.

Mendoj se edhe kjo duhet, gjatë procedimit të mëtutjeshëm të këtij ligji të qartësohet.

Më lejoni që të potencoj edhe një herë transportin e mallrave të veçanta, jo mallrave të rrezikshme sepse ajo do të ishte sipas planit të Ministrisë në një ligj të veçantë, mirëpo unë kisha me thënë mallrave të rrezikuara, si është, do të thotë – bartja e të hollave, e pasurive prej një banke në bankën tjetër, apo bartja për shembull - dhe më lejoni të nderuar deputetë të them – e kartelave të telefonisë "Vala 900" nga Aeroporti deri në vendin e destinuar. Këto janë mallra të veçanta dhe me vlerë në të gjitha shtetet demokratike prandaj edhe janë kompanitë e veçanta të licencuara për bartjen e këtyre mallrave.

Më lejoni t'i propozoj zotit ministër që të konsultojë ligje të shteteve tjera dhe të gjejë formën dhe mënyrën se a përshtatet kjo në këtë ligj dhe t'i shtohet, do të thotë edhe kjo pjesë këtij ligji që është shumë me rëndësi. Ne një ditë duhet të përgatitemi që këto ligje të vlejnë edhe atëherë kur nuk është KFOR-i e UNMIK-u në Kosovë por mbeten në përgjegjësi të kompanive vendore të Kosovës për bartjen e këtyre mallrave.

Më lejoni të propozoj që këtu, gjatë procedimit të mëtejshëm të këtij ligji të saktësohet edhe një herë lidhur me mbipeshën... Unë e dij që në Ligjin për rrugët është kjo e sanksionuar - mbipesha atje, mirëpo mendoj se edhe në transportin rrugor të mallrave duhet të jetë e sanksionuar me një nen të veçantë ndalesa e mbipeshave qoftë në transportet transite nëpër territorin e Kosovës apo të transportit të brendshëm në mënyrë që të kemi një ligj i cili mbronë rrugët tona nga mbingarkesat dhe kjo do të duhej të vlejë edhe për KFOR-in këtu, pra të mjeteve transportuese të KFOR-it dhe të kihen parasysh që mos të dëmtohen rrugët tona.

Edhe një propozim tjetër. Në të gjitha shtetet është e përcaktuar koha kur automjejtet me ngarkesë të rëndë mund të qarkullojnë nëpër rrugët e atij shteti. Zakonisht ato bëhen natën, në mënyrë që të lirohet transporti rrugor në fazën apo kohën kur ai është i mbingarkuar dhe automjetet që bartin udhëtarë apo ato personale të kenë mundësi më të lehtë qarkullimi nëpër territorin dhe rrugët e atij shteti. Pra, këtij ligji i mungon një nen i cili kishte me përcaktuar decidivisht kohën kur janë të lejuara për shembull qarkullimet e këtyre automjeteve të rënda nëpër rrugët e Kosovës.

Më lejoni që ta shpreh përkrahjen e Grupit Parlamentar të Aleancës ndaj këtij ligji dhe ta lus Ministrinë që gjatë procedimit të këtij ligji në Komisionin parlamentar funksional - ta formojë një grup pune i cili do të bashkëpunonte në mënyrë që amendamentimi i këtij ligji të shkojë në rregull dhe të mënjanohen këto diskrepanca dhe ndryshime që janë shfaqë këtu sipas mendimit tonë dhe më lejoni që t'ju ftoj ta miratoni në parim. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Të falemnderit Naim. Fjalën e ka Faik Marolli në emër të Grupit Parlamentar të të Tjerëve.

FAIK MAROLLI:

I nderuari kryesues, të nderuar ministra dhe deputetë,

Ky Projektligj është i qartë dhe leht i kuptueshëm dhe ka rëndësi të veçantë për ne në Kosovë. Pse e them këtë? Sepse me zhvillimin e këtij Projektligji mundësohet edhe zhvillimi i ekonomisë këtu te ne.

Prandaj, Grupi i të Tjerëve e përkrahë në parim këtë Projektligj dhe meqenëse ka hapësirë, në komisione do të korrigjohen dhe plotësohen ato me amendamente që bëhen më vonë. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Të falemnderit zoti Faik. Tash fjalën e ka deputeti Rangjell Nojkiq.

RANDJEL NOJKIĆ:

Dame i gospodo, Radno presedništvo,

Ja sam mislio da, pošto se promenio predsedavajući, da će se i neke navike promeniti, ali nažalost, izgleda da kontinuitet je kontinuitet. Iako sam se javio medju prvima, iako sam napisao da sam član Komisije u svojoj prijavi, izgleda da je Poslanička grupa Koalicije «Povratak» ovde apsolutno baćena na margini pa sam i tako verovatno dobio zadnji reč. Ali, dobro. Nema veze. To su standardi koji verovatno ovi predstavnici iz medjunarodne zajednice prate i oni će to uredno da zabeleže.

No, medjutim, hteo sam da vam kažem... Mi imamo... Jeli mogu da govorim?

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Urdhëroni, hyni në temë Rangjell. Unë jam duke kryesuar mbledhjen dhe me mua mund të flisni.

RANDJEL NOJKIĆ:

Ne!? Pa ja bih vas molio da umirite poslanike kada ja govorim. Bez dobacivanja.

Poslanička grupa Koalicije «Povratak» ima tri principijelne primedbe i te primedbe, ukoliko se ne budu otklonile, zaista ovaj zakon – plašim se – da će biti blokada saobraćaja a ne uredjivanje saobraćaja.

Ove tri primedbe o kojima ću da govorim, one su... vrlo bitno narušavaju interese i prava zajednice. Pre svega zato što su, ovim zakonom, neka rezervisana prava za SPGS ponovo uzurpirana i ponovo su prebaćena na račun ministarstva. Druga, takodje velika primedba jeste da u Radnoj grupi koja je učestvovala u Nacrtu ovog zakona nema predstavnika i eksperata iz srpske zajednice, što takodje pokazuje na izvestan način diskriminacije srpske zajednice. I treća, takodje velika primedba jeste da oni koji su čitali, koji su pratili sve tri verzije zakona vrlo jasno mogu da vide da postoje suštinske razlike u ovim zakonima, upravo zato što nisu oni jezički odnosno u prevodu na adekvatan način prevedene.

Te, zbog toga ja predlažem da se ovaj zakon povuče iz procedure dok se ove stvari ne reše, pre svega u usaglašavanje. Jer mi ćemo praktično imati tri zakona a ne jedan zakon. Tri zakona! Gdegod ima razlike u suštini, onda zaista su to tri zakona a ne pojedinačno, ne zapravo jedan zakon koji je preveden na tri jezika.

Zbog svega ovoga što sam naveo, zaista Koalicija «Povratak» neće glasati za ovaj zakon u načelu. Normalno, daćemo i primedbe ali primedba koja je data vezano za reciprocitet izmedju država i pomenuta je pre svega Srbija mislim da je prvo neumesno a drugo zaista ako se tako nešto desi i ako tako nešto bude ubačena u amandman i bude usvojen u tom zakonu onda - budite sigurni, ali sigurni budite: da će doći do blokade saobraćaja, jer će biti bitno narušeni interesi srpske zajednice, koji neće moći da se prebacuju iz jedne sredine u drugu sredinu zbog ovog problema. Zato vas molim da obratite pažnju na ovo, da shvatite ovo veoma ozbiljno i da ovaj zakon nadje jedno adekvatno rešenje koje će omogućiti transport i komunikaciju svih zajednica na prostorima Kosova «i Metohije» a ne samo jedne zajednice. Hvala.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Falemnderit deputetit Nojkiq. Për hirë të stenogramit dhe të monitorimit dua ta them një sqarim procedural. Deputeti Rangjell Nojkiq është paraqitur si anëtar i Komisionit dhe jo si në emër të Grupit Parlamentar «Kthimi», një. E dyta, veprimi im është në përputhje të plotë me Rregullën 19 pika 3 dhe lus deputetin

Nojkiq ta shikojë këtë rregull dhe Rregulloren e punës me të cilën procedojmë dhe të mos thuani fjalë që janë të pavend këtu. Nuk ka kundërshtim. Nuk është replikë. Është sqarim procedural dhe nuk ka fjalë. Shikone pra Rregullën 19, pika 3.

(Prej vendi: Mogu li ja da objasnim!?)

Fjalën e ka deputeti Ibush Jonuzi.

IBUSH JONUZI:

Zoti kryesues, deputetë të nderuar dhe ministra,

Projektligji për të cilin sot po debatohet në shqyrtim të parë u tha se është i një rëndësie të veçantë, sikurse edhe të gjitha ligjet që janë aprovuar deri tani. Por, për rrethanat që ne kemi në Kosovë, mendojs e ka qenë shumë më e ngutshme dhe shumë e domosdoshme që në kohë sa më të shkurtër ta aprovojmë, por megjithatë tash veç ka ardhur koha. U tha shumçka se është hartuar mjaft mirë, shumpërmbajtësor. Ato që mendohet se duhet të plotësohen u thanë.

Kam vetëm tri çështje shumë të shkurtëra t'i potencoj se pika 23 pikë 4, ku thotë "regjistrimin dhe vërtetimin e rendit të udhëtimit e bën Ministria e Transportit dhe Posttelekomit", mendoj se duhet t'i shtohet "për raste urbane të jenë kompetente edhe organet komunale" në mënyrë që të përcillet më leht dhe t'i bëhet e mundshme qytetarëve të kenë shërbime personale më të lehta.

Pika 23, gjithashtu pikë 5 – "Ministria e Transportit dhe Posttelekomit mbanë regjistrin e rendit të udhtëimit të vërtetuar dhe të regjistruar" edhe këtu mendoj se duhet t'i shtohet "organi komunal kompetent të bëjë regjistrimin dhe evidentimin e veprimtarive që i bën në këtë lëmi".

Dhe, krejt për fund, duke patur parasysh se në shumicën e komunave nuk ekzistojnë drejtori përkatëse, do të thotë të komunikacionit rrugor, duhet të precizohet me një nen të veçantë se në kompetenca të cilës drejtori përkiten shërbimet e kësaj lëmie, sepse shihet qartë se ka përzierje të kompetencave brenda drejtorive komunale.

Ju falemnderit dhe në parim e mbështes Projektligjin.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Të falemnderit deputeti Ibush Jonuzi. Fjalën e ka deputeti Sabit Rrustemi.

SABIT RRUSTEMI:

I nderuari kryesues, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Unë jam i vetëdijshëm se shumë nga vërejtjet që i kisha evidentuar rreth këtij Projektligji mjaft të rëndësishëm për Kosovën u thanë qoftë nga Komisioni funksional, qoftë nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Megjithatë, edhe nëse i përsëris disa nga ato, le të kuptohen si përforcim i vërejtjeve që mendoj do të duhej plotësuar apo amendamentuar në këtë ligj.

Çështja e parë, është pikërisht çështja e gjuhës. Ne këtë e vëmi në spikamë shpeshherë, por vërtetë po na ndodhë kjo në të gjitha ligjet që janë aprovuar deritash në Kuvendin e Kosovës. Këtyre ligjeve nuk iu duhet vetëm një lekturë, por unë mendoj iu duhet edhe një redakturë e mirë nëpër të gjitha ato... dhe nuk do të ishte keq që këtyre t'iu hyjnë redakturës para se të shpallen nga Përfaqësuesi Special dhe të zbatohen në praktikë. E njëjta gjë vlenë edhe për këtë ligj.

Çështja tjetër, që dua ta potencoj, është çështja e transportit rrugor të udhëtarëve. Tepër është përforcuar transporti i operatorëve publik, ndërsa është cunguar transporti i operatorëve privat. E kam fjalën për taksit. Mendoj se kjo çështje do të duhej të rregullohej dhe ata të mos përjashtohen nga transporti rrugor, por t'iu nënshtrohen licencave njëjt sikur operatorët publik, qofshin ata me 4 plus 1 apo me 8 plus 1.

Unë po e marr vetëm një shembull për ilustrim. Çka do të ndodhë me Aeorportin e Prishtinës nëse përmes këtij ligji përjashtohen të gjithë taksit, të cilët nuk do të kenë të drejtë të vijnë prej Aeroportit të Prishtinës në Gjilan, në Prizren, Podujevë apo diku tjetër. Dhe mendoj se kjo duhet të rregullohet dhe t'iu nënshtorhen licenave edhe të tjerët.

Tjetra. Ne kemi taksi që vijnë edhe prej shteteve tjera në Kosovë dhe nuk i nënshtrohen asnjë licencimi, ndërsa tanëve iu mohohet e drejta që të lëvizin nga Gjilani në Viti, në Kamenicë, në Prishitnë, në Ferizaj, e tjera. Mendoj se ka mundësi kjo të ndërrohet.

Te çështja e transportit të veçantë. Përveç shkollarëve të shkollave fillore, mendoj se duhet të përfshihen edhe shkollarët e mesëm në transportin e veçantë.

Çështje, për mua diskutabile, është se ende nuk e kam has në këtë ligj, se prej kujt menaxhohen stacionet e autobusëve? Nuk e kam vërejtur dhe mendoj se duhet të përkufizohet më qartë se prej kujt menaxhohen dhe kush i ka kompetencat për stacionet e autobusëve dhe çka do të ndodhë në relacionin e kompetencave komunë – ministri në këtë drejtim.

Është edhe një çështje tjetër, te neni 59 kujtoj. Po, te neni 59. Për mua është nen i paqart dhe do të duhej të fshihej.

Besoj se, edhe me këto vërejtje, ky ligj ka mundësi të përsoset dhe vërtetë ka mundësi të vëjë një rend në rrugët e Kosovës. Ju falemnderit dhe uroj për këtë ligj.

<u>KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:</u>

Të falemnderit Sabit.

Të nderuar deputetë, tani do ta votojmë Projektligjin në parim.

Kush është për? Ju falemnderit. Është shumica dërrmuese.

A ka kundërvotë? Ju falemnderit.

A ka abstenime?

Prezent janë 89 deputetë dhe me 13 vota kundër, asnjë abstenim dhe shumicë dërrmuese për – miratohet në parim Projektligji për transportin rrugor.

---

Votimi – Glasanje – Voted:
- Për – Za – For ........................Shumica – Vecina – Majority...........
- Kundër – Protiv – Against ........................13..................
- Abstenime – Uzdrzani – Abstaned.............00..................

---

Vetëm ta them edhe procedurën. Sipas Rregullës 19 pika 6 dhe Rregulla 31, Kuvendi ngarkon këto komisione për shqyrtimin e mëtutjeshëm të Projektligjit në fjalë:

1. Komisioni për telekomunikacion, si Komision funksional referues;
2. Komisioni për gjyqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese;
3. Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe
4. Komisioni për buxhet.

Komisionet duhet që në afatin prej 3 javësh të shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Kalojmë në pikën vijuese – Përgjegjet në pyetjet e deputetëve.

Këtu është prezent ministri i telekomunikacionit në Qeverinë e Kosovës, zoti Zef Morina, i cili do të japë një përgjigje gojore në pyetjen e deputetit Ismajl Kurteshi.

Urdhëroni, zoti ministër.

ZEF MORINA:

Ju falemnderit kryesues.

Së pari, kërkoj falje nga zoti deputet, se kjo ka qenë më herët, por në atë kohë ne ishim në udhëtim dhe s'kam qenë këtu, e për atë arsye edhe ndoshta është shty.

Nëse s'i kam harruar pyetjet – kanë qenë shenjat e komunikacionit në rrugë dhe ndërtimi i objekteve afër brezit rrugor.

Në bazë të Ligjit mbi rrugët, Ministria e Transportit dhe Posttelekomunikacionit është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit rrugor në rrugët magjistrale dhe regjionale. Ju e dini që pas përfundimit të luftës, kryesisht ndihmat emergjente në rehabilitimin e rrugëve nuk kanë shkuar kryesisht në mbushjen e gropave apo në një mënyrë përgatitjen e rrugës për qarkullim. Në këtë drejtim nuk ka pasë donacine fare në vendosjen apo ndryshimin e udhëtreguesve gjegjësisht shenjave të komunikacinit, qoftë ato horizontale qoftë ato vertikale. Ndërsa, kjo është bërë tek pasi u krijua departamenti dhe ministria, gjë që të gjitha këto kryhen sipas buxhetit që ndahet, faktikisht buxhetit të Ministrisë që ju veç e keni miratuar vetë. Kështu që, ato mjete të cilat janë ndarë, ne iu kemi dhënë prioritet për rrugët kreysore dhe jemi duke punuar. Tash po duhet që të bëhet ndryshimi, natyrisht edhe përshkrimi i emrave të rrugëve, drejtimet e të gjitha këto, kështu që lypet kohë. Në këtë drejtim kemi punuar aq sa kemi pasë mjete, ndërsa jemi duke punuar natyrisht dhe shpresoj se me ato mjete të cilat i kemi do t'i kryejmë vërtetë të gjitha rrugët të cilat janë në

kompetencë tonën. Ju e dini që brenda komunave, është kompetencë e komunave, nuk është e Ministrisë.

Sa i përket ndërtimit të objekteve afër brezit rrugor. Vërtetë kjo është një brengë shumë e madhe, jo vetëm e Ministrisë po besoj e gjithë qytetarëve të Kosovës, sepse edhe para luftës, menjëherë edhe pas luftës, ndërtimet afër brezit rrugor kanë qenë të pamundura të ndalen, sepse të gjithë personat, të gjithë ata që i kanë ndërtuar këto objekte nuk i kanë rrespektuar bile as rregullat e ligjeve të vjetra të cilat në një mënyrë e kanë ndaluar këtë çështje.

Ministria, në këtë drejtim, ka bërë një marrëveshje me Shërbimin Policor të Kosovës dhe me Policinë e UNMIK-ut që bashkërisht me anëtarët, gjegjësisht me komisionet të cilat janë inspektor për kontrollimin dhe ndërprerjen e këtyre, të dalin në terren dhe të shiqojnë mundësinë e ndalimit. Ju e dini që në territoret e komunave lejet i lëshon komuna, nuk i lëshon Ministria. Ndërsa, pëlqimin për ndërtimin e ndonjë objekti afarist, siç janë pompat e benzineve apo kyçjen në rrugët kryesore mirret nga Drejtoria e Rrugëve, e cila është në kuadër të Ministrisë dhe në bazë të raporteve dhe statistikave që kemi ne, sinçerisht po ju them, që të gjitha ato objekte të cilat janë ndërtuar nuk kanë pëlqim as nga Drejtoria e Rrugëve dhe, edhe për kundër asaj, Minsitria ka bërë fletpadi ndaj të gjithë atyre dhe kemi listën e kompanive apo personave të cilat i kanë ndërtuar këto... Kemi dalë në terren dhe s'bashku me policinë kemi kërkuar ngalimin e tyre, por fatkeqësisht nuk kemi pasur mundësi realizimi.

Ju e dini që aprovimi i Ligjit mbi rrugët është bë domethënë në muajin qershor, kështu që tash jemi duke i nxjerrë aktet nënligjore të cilat decidivisht do ta ndalojnë... Ne kemi njoftuar edhe kuvendet komunale që të mos japin leje. Ata të cilët i kanë ndërtuar objektet afër rrugës, domethënë në bazë të ligjit përcaktohet brezi rrugor sa është për objekte afariste, për objekte individuale, për objekte të natyrave të ndryshme dhe është caktuar distanca sa duhet të jetë, por disa i kanë rrespektue e disa nuk i kanë rrespektu. Natyrisht ky është problem edhe për ne, sepse ne mendojmë të gjitha rrugët magjistrale dhe regjionale t'i zgjerojmë dhe t'i bëjmë vërtetë rrugë të kategorisë me karakter të normave ndërombëtare por ekziston mundësia që këto objekte, natyrisht, të rrënohen. Ata të cilët nuk kanë leje, përgjegjësinë e kanë marrë mbi vete. Ministria çdoditë është në terren me inspektorët e tyre dhe iu tërheq vërejtje, por kemi pasë raste që nganjëherë edhe janë kërcnuar duke thënë se "ne nuk dëshirojmë me ju pa këtu, sepse ky është objekt që unë e kam ndërtue" e ku ta dij, "kam leje gojore" e tjera. Përndryshe, një shembull po ua jap. Me policinë e UNMIK-ut që kemi qenë në një vend, ka qenë vetë komandanti, zoti... S'po më kujtohet emri i tij se si quhet, kur pronarit të objektit i jipet me shkrim që ta ndërpresë punën – nuk e ndërprenë. Ne nuk dijmë çka të bëjmë, me përjashtim që tash së bashku me Policinë tonë të dalim në vend, domethënë dhe t'i rrënojmë ato objekte.

Edhe një herë po them, vërtetë ne jemi në një pozitë jo të mirë por besoj se qytetarët tanë do të jenë të vetëdijshëm dhe do të dijnë ta rrespektojnë ligjin ashtu sikur që edhe ju e keni aprovuar dhe të gjithë ne e kemi miratuar. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Të falemnderit ministër. Ka të drejtë deputeti Ismajl Kurteshi për një pyetje shtesë për ministrin.

ISMAJL KURTESHI:

Së pari, i falënderohem minsitrit Morina për përgjigjen. Unë do ta bëj edhe një pyetje, do të thotë edhe një shqetësim timin do ta paraqes këtu.

Ndodhë shumshpesh në rrugët tona magjistrale, mungojnë shenjat horizontale, vijat ndarëse e rrugëve e cila është rrezik i madh për ata që vozisin dhe rrugët të cilat janë rreth kodrave ku ka mundësi që të bjerë dheu ose gurët ato vërtetë nuk mbahen në një nivel të cilin do të duhej të mbaheshin.

Po ashtu, në bisedë me disa ekspert të shenjave, për shenjat të cilat në disa raste janë të vendosura pa ndonjë arsye, është kufizimi i caktuar pa ndonjë arsye, thuhet se kjo është bërë për shkak të intervenimit të ndonjë individi i cili ka interes personal për ta kufizuar shpejtësinë. Unë ju kisha lutur që, si Ministri, të merrni masa të duhura dhe t'i evitoni këto të meta të cilat i përmenda. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Ju falemnderit. A dëshironi ministër t'i përgjigjeni? Urdhëroni pra.

ZEF MORINA:

Sa i përket sinjalizimeve horizontale keni të drejtë, por vërtetë – kompanitë tona të cilat po i kryejnë këto punë, them sinqerisht, nuk janë të përgatitura që t'i kryejnë ato. Brenda dy-tre muajve ato vija shlyhen ose në një mënyrë humbin efektin e tyre. Këtu është në pyetje natyrisht materiali. Po vijnë kompani me çmime shum të ulëta. Ne po kemi presione në atë kuptimin thjeshtë që ta ruajmë buxhetin, ta shfrytëzojmë për ndonjë punë tjetër dhe jemi të detyruar që

kompanisë me çmim shumë të ulët me ia dhënë punën dhe ai kur po bëhen tre muaj po prishet. Tash kemi marrë qëndrim që vetëm ata të cilët kanë referencë, qoftë vendor, qoftë i huaj – do t'i kryen ato punë, pavarësisht kush do të jetë. Këtu plotësisht keni të drejtë.

Sa i përket sinjalizimeve vertikale, apo për vendosjen e tabelave kufizuese, sinqerisht po them – ne nuk jemi në dijeni dhe nuk besoj se ka të atillë që kërkojnë me vë afër pronës së vet apo shtëpisë së vet e ku ta dij... Përndryshe, ato janë të përcaktuara me rregulla ndërkombëtare, varësisht prej ngarkesës, varësisht prej lokacionit, varësisht prej pozicionit të rrugës – edhe kufizimi i shpejtësisë. Nëse keni ndonjë rast, kishte me qenë mirë të na e tregoni. Ne do të intervenojmë dhe nuk do të lejojmë gjëra të tilla. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Të falemnderit ministër. Prezent është edhe ministri i Qeverisë së Kosovës, zoti Bogdanoviq për t'iu përgjigjur me gojë në pyetjen e deputetit, po ashtu Ismajl Kurteshi. Urdhëroni zoti ministër.

GORAN BOGDANOVIĆ:

Poštovano Predsedništvo, poštovani narodni poslanici,

Ja sam gospodinu Ismajlu poslao pismeni odgovor za prošlu sednicu Vlade, sednicu Skupštine, izvinjavam se. Medjutim, ja sam prisustvovao prošloj sednici Skupštine, i nisam mogao do kraja da prisustvujem iz objektivnih razloga. Znači, imao sam neki zakazani sastanak, ja se izvinjavam znači za tako nešto. Ali, nema veze, možemo sada, znači sada ćemo odgovoriti.

Pitanje glasi: Šta je preduzeto od strane vašeg Ministarstva za pravovremeno snabdevanje kvalitetnijim semenom po prihvatljivim cenama?

Pitanje je dosta interesantno. Ja ću vam odmah reći da je Ministarstvo, u okviru svoje nadležnosti, tvorac opštih politika za pripremu, implementaciju, nadgledanja zakona o poljoprivrednom sektoru. U okviru politika u sektoru za seme, kao što znate, mi smo doneli Zakon o semenu s tim što smo doneli i odredjene uredbe u okviru Ministarstva, gde smo regulisali proizvodnju, promet i sadnju semenskog materijala. U okviru ovih politika Ministarstvo je, zajedno sa Ministarstvom finansija, podnelo zahtev Centralnom fiskalnom savetu za redukciju carinske takse i kao što znate sigurno da nam je odobreno, znači skinuta je taksa za uvoz semenske pšenice na Kosovo. Mi smo takodje tražili, zajedno u saradnji sa Ministarstvom za finansije da se skine i takozvani PDV –

znači takozvani porez na dodatu vrednost. Medjutim, nismo imali razumevanje od strane Fiskalnog saveta, ali svakako možemo biti zadovoljni s tim što je ukinuta i sama znači carina na uvoz semenske robe.

Takodje Ministarstvo i administrativnim uputstvom ukinula neka zakonska uredjenja, kao što je lista odobrenih variateta. Mi smo, kao što znate, bili ovaj doneli uredbu jednu gde i odredjene sorte semena su mogle da se uvoze na Kosovo s tim što smo mi to sada ukinuli i dozvolili smo da se više vrsta semena uvozi na Kosovo iz prostog razloga što je svuda u okruženju ove godine, kao što znate, bila suša, svud je bio deficit sa semenskom robom, naravno sve države su podmirili svoje potrebe pa su odredjene kontingente koje su imale dozvoljavale da se izvoze, u ovom slučaju, na Kosovo.

Takodje, u okviru svojih politika, Ministarstvo utvrdilo potrebe za semenom, naravno u saradnji sa opštinama i gde smo od prilike ustanovili da za jesenju setvu potrebno negde oko 20. hiljada tona semenske pšenice. Od tog 20. hiljada semenske pšenice 1.702 tone ili 20% je bilo proizvedeno ovde na Kosovu, s tim što individualni poljoprivredni proizvodjači proizveli negde oko 4 hiljade i nešto, malo jače, od prilike svoje semenske robe, s tim što ta semenska pšenica, u ovom slučaju nije bila certifikovana. Znači, nije bila, na neki način, registrovana kao semenska roba. I zato je na Kosovu, do današnjih dana, uvezeno negde oko 14. hiljada tona semenske pšenice i mi smatramo u Ministarstvu da je to sasvim dovoljno za podmirivanje potreba naših individualnih poljoprivrednih proizvodjača.

Takodje, u cilju da se ne ponovi ovakva situacija koju smo imali u ovoj godini, i možemo slobodno reći da smo imali odredjenih problema znači u snabdevanju sa semenskom robom, Ministarstvo u okviru svojih politika je zauzelo odredjene stavove i zahtevaće naravno da domaći proizvodjači semena budu stimulisani na neki način. Ne na neki način, nego osnivanjem fonda. Mi smo i prošle godine, i ove godine podneli zahtev i Vladi Kosova i Centralnom fiskalnom savetu i mi smo imali razumevanje što se tiče same Vlade, ali od strane Centralnog fiskalnog saveta nismo imali razumevanje za osnivanje takvog fonda da bi mogli našim farmerima da nadoknadimo na neki način, znači štete koje pretrpe ili to bilo u obliku suše, ili elementarnih nepogoda, ili poplave, požare i tako dalje. Medjutim, nažalost, kao što sam rekao, znači nismo imali razumevanje od Ekonomskog fiskalnog saveta. Naravno, mi ćemo i dalje težiti da unapredjujemo tu granu semenarstva.

Kao što znate, mi imamo odredjene ugovore koje smo sklopili sa pojedinim institutima i sa pojedinim inostranim partnerima i gde se faktički prave odredjene fabrike ovde semena i naravno gledamo da aktiviramo i što bolje upotrebimo našu postojeću fabriku u Kljini da bi mogla da podmiruje potrebe za semenskom pšenicom za celo Kosovo. Hvala.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Falemnderit, zoti minister. Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje shtesë.

ISMAJL KURTESHI:

I falënderohem ministrit për përgjigjen. Unë këtë pyetje e kam bërë për arsye se kam konsideruar se Ministria e Bujqësisë, në rastin e mbjelljeve vjeshtore të sivjetme - nuk e ka kryer punën si duhet.

Këtë po e them për arsye se në territorin e Kosovës, gjatë kohës optimale të mbjelljeve vjeshtore nuk ka pasë farë të mjaftueshme, nuk ka pasë farë cilësore. Çmimi i farës ka qenë tepër i lartë dhe fara është shitur me dy çmime. Këtë po e them, e edhe ministri e tha vetë, se është shitur farë e pacertifikuar për arsye se bujqit nuk kanë arritur të sigurojnë farë të certifikuar prandaj ata e kanë bërë vetë përzierjen e farës dhe e kanë shitur. Në treg ka patur edhe farë të vjetër, e cila ka qenë e përgatitur për vite tjera, nuk është shitur dhe sivjet, për shkak të mungesës së farës të sivjetme, është shitur fara e mëhershme. Dhe sipas informatave që i kam fara është shitur me këto çmime:

- në enklava 26 euro 100 kilogram farë, kurse
- në pjesë tjera 45 euro për 100 kilogram farë,

që vërtetë është një padrejtësi e madhe që iu është bërë bujqve të Kosovës ose një pjese të bujqve të Kosovës.

Unë e dëgjova ministrin në përgjigjen që më është dhënë, për përpjekjet e Ministrisë që të sigurojnë ndonjë subuencion për bujqit, mirëpo mendoj se një insistim i tillë do të duhej të ishte shumë më i madh pasi që dihet – dëmet që i ka pësuar bujqësia kosovare gjatë viteve, në të vërtetë gjatë luftës dhe tani, bujqit ende nuk kanë arritur që vetë - pa ndihmën edhe të buxhetit tonë të përbashkët - t'i tejkalojnë këto vështirësi dhe ta kthejnë bujqësinë në gjendjen të cilën e kanë pasë para luftës. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Të falemnderit Ismajl. Ministër, a dëshironi të përgjigjeni?

GORAN BOGDANOVIĆ:

Zahvaljujem se. Ja samo nešto da kažem za cenu. Mi u Ministarstvu niti odredjujemo cenu niti odobravamo cenu, niti uvoza niti prodaje. Znači, niti ćemo dozvoliti da u Ministarstvu mi budemo ti koji ćemo da formiramo znači prodajnu cenu. Ovde je, gospodo, tržišna ekonomija. Zakon ponude i tražnje mora da se poštuje. Znači, mi kao Ministarstvo možemo samo, kroz našu politiku, da li to bila zakonodavna, da li to bilo uopšte, znači kako je budemo vodili – zavisiće količine semena i u opšte kvalitet razvoja poljoprivrede na Kosovu. A inače, što se tiče cena, da li je u enklavama bila 28 evra a ovamo 45, mi stvarno nemamo te podatke u Ministrastvu i niti se trudimo da utičemo na prodajnu cenu, ne samo semenske pšenice nego svih poljoprivrednih proizvoda koji se prodaju na Kosovu.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Falemnderit ministër. U krye edhe kjo pikë e renditë ditës – Përgjigjet në pyetje të deputetëve.

Kalojmë në pikën e fundit – Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare më 4 dhjetor 2003.

Këtu është, pra një ndryshim i vogël – do të thotë pika e parë në seancën plenare të 4 dhjetorit...

Vetëm një moment. Lidhur me rendin e ditës doni apo...? Pritni një moment, mos u ngutni. Seancë plenare nuk ka më 27, është ditë feste. Më 4 dhjetor do të jetë seanca e ardhshme e radhës.

Nën 1, do të jetë - Projektligji për kadastër, këtë që e shtyem sot;

Nën 2, do të jetë - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet dhe pajisjet medicinale;

Nën 3, do të jetë - Shqyrtimi i Projektbuxhetit për vitin 2004.

Më lejoni tash t'ju them këtë. Sipas Rregullores, të drejtën e fjalës, vërtetë propozimit, e kanë vetëm shefat e grupeve parlamentare.

Unë sot kam bër një përjashtim ndaj deputetit Muhamet Kelmendi, i cili është paraqitur dhe kërkuar të japë një propozim. Janë edhe dy propozues – deputetë tjerë që dëshirojnë të propozojnë. Unë jam që ta bëjmë këtë përjashtim dhe

fjalën e ka deputeti Muhamet Kelmendi, pastaj Alush Gashi dhe Fatmir Rexhepi. Dhe, nuk ka të tjerë.

MUHAMET KELMENDI:

Zonja dhe zotërinj,

Duke u mbështetur në Rregulloren e punës së përkohshme të Kuvendit të Kosovës, në Rregullën 26... Vërtetë unë kam insistuar si çështje e ngutshme të futet kjo, e jo të instalohet në kuadër të propozimit të rendit të punës për mbledhjen e ardhshme, por si çështje pra e ngutshme, sepse është e përcaktuar kështu në Rregullore.

Fjala është, siç e dini edhe ju, se në Kosovë ka filluar ka muaj të tërë çështja e privatizimit. Në rregullore po ashtu ne e kemi aprovuar dhe është krijuar Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit, i cili merret me çështjen e tillë. Është kryer rundi i parë dhe i dytë. Të njëjtën kohë ka ardhur deri tek stopimi i kësaj çështjeje dhe nga informacionet e ndryshme, nëpërmjet mediave të shkruara dhe elektronike, del se jo ky ligj është, jo kjo çështje është fajtore... Me fjalë të tjera, Kuvendi mbetet si një institucion kryesor ligjdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor në Kosovë jashtë kësaj rrjedhe që mendoj se nuk do të duhej të mbetet jashtë, sepse është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme, një çështje ku varet në tërësi zhvillimi ekonomik i shoqërisë kosovare, varet punësimi, punëtorët nuk marrin të ardhurat e veta, dy runda janë kryer, duhet të shkohet edhe më tutje kah privatizimi.

Mendoj se Kuvendi duhet të kërkojë nga Qeveria informacion të drejtpërdrejtë të kësaj natyre – pse është ardhur deri te ndërprerja e kësaj; me çfarë ligji kemi të bëjmë diskriminues i cili po ashtu aktualisht, sipas mjeteve të informacionit, është paraqitur si çështje që duhet të rrespektohet dhe i cili është nxjerrë pas marsit të vitit 89; të kërkohen nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit informacione të drejtpërdrejta dhe ky Kuvend të thirrë një seancë të veçantë, bile është e rrugës - shumë shpejt, ku do të marrin pjesë të gjitha organet kompetente që janë marrë me këtë çështje, në radhë të parë Qeveria dhe të informohemi me shkrim për procedurën se deri ku ka shkuar. Sepse, një ndër çështjet kryesore për zhvillim të mëtejshëm të shoqërisë kosovare është privatizimi. E në qoftë se këtu krijohen probleme siç janë krijuar, në qoftë se këtu paraqiten vështirësi dhe në qoftë se këtu vihet në shfrytëzim ose në disponim ligji i tillë i cili është thënë në mjetet e informacionit, atëherë ne mund të nxjerrim ligje, mund të nxjerrim akte të tjera normative, ministritë mund të mirren me çështje - por shoqëria nuk ecë përpara. Pa bazën ekonomike nuk ka as superstrukturë.

Prandaj ne kësaj çështje duhet t'i japim një rëndësi themelore dhe mendoj se ky Kuvend duhet në mënyrë urgjente t'i ftojë kompetentët dhe të merret me kompetencë për këtë. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Të falemnderit deputeti Muhamet Kelmendi.

T'ju informoj se Kryesia dje e ka diskutuar këtë çështje dhe do ta fusë në rend të ditës në njërën nga seancat e ardhshme, do të thotë për një raport të AKM dhe çështjen e privatizimit.

Fjalën e ka deputeti Alush Gashi.

ALUSH GASHI:

I nderuari kryesues,

Me pëlqim të kryetarit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, akademik Sabri Hamitit, ju drejtohem në emër të Grupit Parlamentar të LDK lidhur me çështjet e privatizimit.

I nderuari kryesues, kohë më parë është ndalur ky proces – procesi i privatizimit. Është kjo një gjendje që mund të përshkruhet si një goditje shumë e fuqishme për zhvillimin e proceseve ekonomike në Kosovë, ndoshta edhe më tepër se vetëm proceseve ekonomike, mund të thuhet ndoshta edhe për proceset e tërësishme në Kosovë.

Aq sa është dhënë në opinion, arsyet për ne janë të papranueshme, nuk janë të justifikueshme, andaj në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e nderuara Kryesi, kërkojmë që ta radhitni në një prej seancave të ardhshme. Ju falemnderit shumë.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Ju falemnderit deputeti Alush Gashi. Do të thotë i njëjti informacion do të jetë në seancë. E ka fjalën deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI:

Të nderuar deputetë, i nderuari kryesues,

Lidhur me rendin e ditës që është propozuar nga Kryesia kam një vërejtje, edhe në konsultim me kryetarin e Komisionit për buxhet dhe si anëtar i Komisionit funksional, është lidhur me caktimin e kësaj pike, do të thotë – shqyrtimi i Projektbuxhetetit për vitin 2004 dhe atë konsideroj se duhet të bëhet kjo por në konsultim dhe të jetë i përgatitur atëherë kur këto komisione kanë mundësi që të ndihmojnë vetë seancën e Kuvendit për shqyrtimin e këtij Projektbuxheti sepse ne ende zyrtarisht s'e kemi marrë atë. Kështu që mendojmë, që të mos ngarkohet rendi i ditës edhe me pika të tjera, por për shkak të rëndësisë që ka buxheti i Kosovës, të jetë seancë e veçantë – ditën kur e cakton, domethënë brenda ditëve të punës, por jo në pika të tjera të mbetet një orë ose gjysmë ore për ta shqyrtuar buxhetin me të cilin duhet të punojmë vitin e ardhshëm. Prandaj, ju lusim ta keni në konsideratë këtë sygjerim.

Dhe, çështja e dytë që dola, ishte po ajo që u potencua këtu, por edhe për shkak të Kuvendit edhe për shkak të vetë Kryesisë e cila besoj e ka marrë shkresën e tri komisioneve parlamentare, atij të buxhetit, të transportit dhe të ekonomisë e financave më herët për ta shqyrtuar ecurinë dhe çështjen e privatizimit dhe nuk e ka vë në rend dite, prandaj edhe për atë, në emër të këtyre tri komisioneve që keni marrë ju letrën, kërkojmë të bëhet kjo në seancë të veçantë, të përgatitet mirë edhe nga Qeveria, edhe nga Kuvendi sepse është një ndër çështjet më të rëndësishme sot që prekin do të thotë zhvillimin ekonomik dhe perspektivën e Kosovës. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Falemnderit deputetit. Kryesia do të procedojë edhe në përputhje me sygjerimet tuaja. Urdhëroni, Hydajet Hyseni, anëtar i Kryesisë.

HYDAJET HYSENI:

I nderuar zoti kryesues, të nderuar kolegë deputetë,

Unë desha të theksoj dy çështje. Së pari, nismën për të debatuar në këtë sallë, në këtë seancë ose në këtë Kuvend në një seancë të veçantë për privatizimin - Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka inicuar shumkohë më parë.

Ju lutem... dhe e ka inicuar në mënyrën siç inicohen çështjet e tilla – me shkresë, të dërguar Kryesisë dhe me mbështetjen e duhur të deputetëve dhe në kohën e duhur, ju lutem.

Unë desha vetëm ta tërheq vërejtjen se kjo do të thotë është në procedurë dhe në mbledhje të Kryesisë është tërhequr vërejtja disa herë pse kjo zvarritet dhe mua më vjen mirë që tani kjo gjend mbështetjen - po post festum - dhe desha edhe një herë të them se Grupi Parlamentar, jo vetëm që e mbështet por e ka patur edhe të inicuar me kohë.

Dhe, çështja e dytë – mirë që mbledhja jonë shtyhet për një javë më vonë, por do të ishte mirë të theksohet qartë arsyeja se 28 nëntori është ditë feste dhe kjo do të ishte mirë të kihet parasysh edhe prej institucioneve tjera sepse ka një konfuzion lidhur me këto çështje. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Të falemnderit Hydajet. Të nderuar deputetë, e shpall të mbyllur këtë seancë plenare.

Seanca përfundoi punën në orën 13,10.

E transkriptoi RT (1-50) –(LG fq.28-29/MJ), Zyra E-04, tel.211-860